

KOMUNA E TUZIT
KOMISIONI KOMUNAL ZGJEDHOR I TUZIT

Në bazë të nenit 13 paragrafi 2 të Ligjit mbi zgjedhjen e këshilltarëve dhe deputetëve („Fleta zyrtare e RMZ” nr. 4/98, 5/98, 17/98, 14/00, 18/00, 73/00, 9/01, 41/02, 46/02, 45/04, 48/06, 56/06 dhe „Fleta zyrtare e MZ”, nr. 46/11, 14/14, 47/14, 12/16, 60/17 dhe 10/18) Komisioni komunal zgjedhor i Tuzit, përcakton:

KALENDARIN ZGJEDHOR
PËR ZBATIMIN E VEPRIMEVE ZGJEDHORE PËR ZGJEDHJE
TË CILAT DO TË MBAHEN MË 05.03.2023

I. VEPRIMET ZGJEDHORE

1. Presidenti i Malit të Zi më 28.12.2022, ka sjellë Vendimin mbi shpalljen e zgjedhjeve për zgjedhjen e këshilltarëve në Kuvendin e komunës së Tuzit. Zgjedhjet do të mbahen më 05.03.2023.
2. Komisioni komunal zgjedhor i Tuzit përcakton dhe publikon kalendarin zgjedhor të afateve për zbatimin e veprimeve zgjedhore të përcaktuara me ligj.

Në pajtueshmëri me Ligjin mbi zgjedhjen e këshilltarëve dhe deputetëve, Komisioni komunal zgjedhor i Tuzit kryen veprimet zgjedhore nga kompetenca e vetë:

1. Lista zgjedhore për zgjedhje të këshilltarëve dorëzohet Komisionit komunal zgjedhor të Tuzit jo më parë se 20 ditë pas shpalljes së zgjedhjeve (neni 46).

Duke filluar më: 18.01.2023.

dhe jo më vonë se 25 ditë para ditës së caktuar për mbajtjen e zgjedhjeve.

Afati: 07.02.2023 deri në orën 24.

2. Organi kompetent i transmetuesit publik dhe transmetuesit komercial dhe jofitimprurës janë të detyruar të miratojnë dhe të vënë në dispozicion publikut rregullat që përcaktojnë paraqitjen e kandidatëve për listat zgjedhore jo më vonë se 10 ditë nga data e shpalljes së zgjedhjeve (nenet 55 dhe 64).

Afati: 07.01.2023 deri në orën 24.

3. Parashtruesi i listës zgjedhore të përcaktuar do të përcaktojë përfaqësuesin e vet të autorizuar në përbërjen e zgjeruar të Komisionit komunal zgjedhor të Tuzit të cilët mund të marrin pjesë dhe në mënyrë të vlefshme vendosin **njëzetë (20)** ditë para ditës së përcaktuar për mbajtjen e zgjedhjeve (neni 26 paragrafi 1 i Ligjit mbi zgjedhjen e këshilltarëve dhe deputetëve).

Duke filluar më: 13.02.2023

4. Lista e përgjithshme zgjedhore shpallet publikisht nga Komisioni komunal zgjedhor të Tuzit jo më vonë se 15 ditë para ditës së caktuar për mbajtjen e zgjedhjeve (neni 26).

Afati: 17.02.2023 deri në orën 24.

5. E drejta e mbulimit mediatik ndalohet (fillon heshtja parazgjedhore) **24 orë** para ditës së mbajtjes së zgjedhjeve (neni 6 paragrafi 3 dhe 64a).

Lejohet deri më 03.03.2023 deri në orën 24

6. Brenda 15 ditëve para ditës së zgjedhjeve, nuk lejohet publikimi i rezultateve të sondazheve të opinionit publik, hulumtimeve dhe analizave të tjera që kanë të bëjnë me vendimin e votuesit në lidhje me vlerësimin e rezultateve të zgjedhjeve në programet e shërbimeve transmetuese dhe mediave të tjera (neni 63).

Lejohet deri më 17.02.2023 deri në orën 24

II. REGJISTRI ZGJEDHOR, VENDVOTIMET DHE KËSHILLAT ZGJEDHOR

a) Regjistrat zgjedhor

Regjistri zgjedhor mbahet për trevën e vetëqeverisjes lokale sipas vendvotimeve. Lista zgjedhore përfundohet më së voni **dhjetë (10)** ditë para ditës së përcaktuar për mbajtjen e zgjedhjeve (neni 18 paragrafi 1 i Ligjit mbi regjistrat zgjedhorë).

Afati: 22.02.2023 deri në orën 24.

Ministria përgjegjëse për listat zgjedhore ua dërgon zgjedhësve njoftimin për zgjedhjet, jo më vonë se shtatë ditë para ditës së zgjedhjeve.

Afati: 25.02.2023 deri në orën 24.

Ministria përgjegjëse për listat e zgjedhësve, për qëllime të identifikimit elektronik të zgjedhësve, në vendvotim, krijon një version elektronik të ekstraktit nga lista e zgjedhësve për çdo qendër votimi në mediumin elektronik përkatës brenda 72 orëve nga dita e marrjes së aktvendimit mbi mbylljen e listës zgjedhore (neni 68a paragrafi 7).

Afati: 25.02.2023 deri në orën 24.

Ministria e punëve të brendshme, brenda 48 orëve nga dita e shpalljes së zgjedhjeve, publikon në të gjitha gazetat ditore që botohen në Mal të Zi dhe në faqen e saj në internet një paraqitje tabelare numerike të të dhënave për ndryshimet në listën e zgjedhësve në tërësi dhe sipas njësive të vetëqeverisjes lokale në lidhje me listën zgjedhore sipas së cilës janë mbajtur zgjedhjet e mëparshme në nivel shtetëror (neni 17 paragrafi 1 i Ligjit për Listën zgjedhore)

Afati: 30.12.2022 deri në orën 24.

Brenda 3 ditëve nga data e shpalljes së zgjedhjeve, Ministria e punëve të brendshme përmes mjeteve të informimit publik dhe në ueb faqen e saj njofton se paraqet listën zgjedhore, përkatësisht një pjesë të listës zgjedhore për njësinë e vetëqeverisjes lokale për të cilën janë shpallur zgjedhjet, për inspektim nga zgjedhësit dhe i njofton zgjedhësit për kohën dhe mënyrën e inspektimit dhe mundësinë për të kërkuar ndryshimin e të dhënave të shënuara në listën zgjedhore (neni 16).

Afati: 31.12.2022 deri në orën 24.

Ministria e punëve të brendshme publikon, brenda 48 orëve nga dita e përfundimit përfundimtar të listës së zgjedhësve, në të gjitha gazetat ditore të Malit të Zi dhe në faqen e saj të internetit, një paraqitje tabelare numerike të të dhënave për ndryshimet në listën e zgjedhësve në tërësi dhe nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, për zgjedhësit që kanë të drejtë vote dhe bazën e fitimit të saj, si dhe të dhënat për personat që kanë humbur të drejtën e votës dhe bazën e humbjes së saj (neni 17 paragrafi 2).

Afati: 24.02.2023 deri në orën 24.

b) Përcaktimi dhe shpallja e vendvotimeve dhe emërimi i këshillave zgjedhor

Vendvotimet përcakton Komisioni komunal zgjedhor i Tuzit, në propozim të organit kompetent për mbajtjen e regjistrit zgjedhor, më së voni **njëzet (20)** ditë para ditës së mbajtjes së zgjedhjeve (neni 65 paragrafi 2 i Ligjit mbi zgjedhjen e këshilltarëve dhe deputetëve).

Afati: 12.02.2023 deri në orën 24.

Komisioni komunal zgjedhor i Tuzit, më së voni **dhjetë (10)** ditë para ditës së mbajtjes së zgjedhjeve shpall njoftim se cilat vendvotime janë përcaktuar dhe cilët votues do të votojnë në vendvotime të caktuara (neni 65 paragrafi 4).

Afati: 22.02.2023 deri në orën 24.

Aktvendimi të cilin partitë politike kanë të drejtë të propozojnë përfaqësuesit në përbërjen e përhershme të këshillave zgjedhor, Komisioni komunal zgjedhor i Tuzit ka obligim të sjellë më së voni **pesëmbëdhjetë (15)** ditë para ditës së mbajtjes së zgjedhjeve (neni 35a paragrafi 1 i Ligjit mbi zgjedhjen e këshilltarëve dhe deputetëve).

Afati: 17.02.2023 deri në orën 24.

Ky aktvendim nga paragrafi 1 i nenet 35a KKZ i Tuzit dorëzon të gjithë parashtruesve të listave zgjedhore të konfirmuara në afat prej **24 orëve** nga momenti i sjelljes.

Afati: 18.02.2023 deri në orën 24.

Komisioni komunal zgjedhor i Tuzit me sjelljen e aktvendimit mbi shpalljen e listës zgjedhore, me konkludim përcakton se cili parashtrues i listës zgjedhore plotëson kushtet për përcaktimin e përfaqësuesve të vet në përbërjen e zgjeruar të këshillave zgjedhor. Konkludimi mbi plotësimin e kushteve për përcaktimin e përfaqësuesve të parashtruesit të listës zgjedhore në përbërjen e zgjeruar të këshillave zgjedhor KKZ i Tuzit dorëzon parashtruesit të listë zgjedhore, në afat prej **24 orëve** nga

momenti i përcaktimit të vendvotimit. Parashtruesi i listës zgjedhore do të përcaktojë përfaqësuesin e vet të autorizuar në përbërjen e zgjeruar të këshillit zgjedhor dhe mbi këtë të njoftojë KKZ të Tuzit e cila më së voni **24 orë** nga momenti i dorëzimit të njoftimit, me konkludim sipas emrit përcakton personat të cilët hyjnë në përbërjen e zgjeruar të këshillit zgjedhor.

Përfaqësuesi i autorizuar merr pjesë në punën e këshillave zgjedhor dhe në mënyrë të vlefshme vendosë **pesë (5)** ditë para ditës së përcaktuar për mbajtjen e zgjedhjeve.

Duke filluar më: 28.02.2023.

Komisioni komunal zgjedhor i Tuzit emëron këshillin zgjedhor për çdo vendvotim më së voni **dhjetë (10)** ditë para ditës së përcaktuar për mbajtjen e zgjedhjeve (neni 35 paragrafi 6).

Afati: 22.02.2023 deri në orën 24.

Veçanërisht më kërkesë të arsyetuar të partisë politike, gjegjësisht grupit të votuesve që ka arritur të drejtë të propozoj përfaqësuesit në përbërjen e përhershme të këshillit zgjedhor, përbërja e këshillit zgjedhor mund të ndërrohet edhe pas skadimit të këtij afati, e më së voni **12 orë** para hapjes së vendvotimeve.

Afati: 04.03.2023 deri në orën 19.

Kryetari i këshillit zgjedhor merr materialin zgjedhor nga Komisioni komunal zgjedhor i Tuzit më së voni **48 orë** para mbajtjes së zgjedhjeve (neni 75).

Afati: 02.03.2023 deri në orën 24.

Këshilli zgjedhor më së voni në afat prej **gjashtë (6)** orëve nga momenti i mbylljes së vendvotimit, do të dorëzoj materialin zgjedhor Komisionit komunal zgjedhor të Tuzit (procesverbalin, ekstraktin nga regjistri zgjedhor, fletëvotimet, kuponët kontrolluese të ndara nga fletëvotimet, kërkesat për votim me anë të zarfit, vulën e këshillit zgjedhor etj.) (neni 91 i Ligjit).

Afati: 06.03.2023 deri në orën 02.

III. REZULTATET E PËRKOHSHME DHE PËRFUNDIMTARE

Komisioni komunal zgjedhor i Tuzit përcakton rezultatet e përkohshme në afat prej 12 orëve nga momenti i dorëzimit të raporteve të komisioneve komunale zgjedhore (neni 91 paragrafi 2).

Afati: 06.03.2023 deri në orën 14.

Komisioni komunal zgjedhor i Tuzit përcakton rezultatet përfundimtare të zgjedhjeve për këshilltarë në afat prej 12 orëve nga momenti i skadimit të afatit për dorëzimin e kontestit gjegjësisht ankesës, gjegjësisht nga momenti i përfundimit ose përmbarimit të vendimeve të sjella sipas kontestit apo ankesës (neni 98 paragrafi 1).

Rezultatet përfundimtare të zgjedhjeve për këshilltarë publikohen në „Fletën zyrtare të Malit të Zi- dispozitat komunale”, më së voni **pesëmbëdhjetë (15)** ditë nga dita e mbajtjes së zgjedhjeve (neni 99).

Afati: 20.03.2023 deri në orën 24.

Mandati i përfaqësuesve të autorizuar të listave të dorëzuara zgjedhore në Komisionin komunal zgjedhor të Tuzit përfundon në ditën e përcaktimit të rezultateve përfundimtare të zgjedhjeve.

Ky afat skadon më 20.03.2023 deri në orën 24.

IV. VËZHGESIT E ZGJEDHJEVE

Vëzhguesit e huaj të interesuar mund të përcjellin ecurinë e procesit zgjedhor nga dita e shpalljes së zgjedhjeve deri në publikimin e rezultateve përfundimtare (neni 111v).

Vëzhguesit e huaj të interesuar paraqitjen për vëzhgimin e zgjedhjeve e parashtrojnë në Ministrinë e punëve të jashtme më së voni dhjetë (10) ditë para ditës së mbajtjes së zgjedhjeve.

Afati: 22.02.2023 deri në orën 24.

Komisioni komunal zgjedhor në afat prej **48 orësh** nga dita e pranimit të paraqitjes lëshon autorizime zyrtare për vëzhgimin e zgjedhjeve ose me aktvendim refuzon lëshimin e autorizimit.

Organizatat joqeveritare të vendit të interesuara për përcjelljen e zgjedhjeve paraqitjen për vëzhgim e parashtrojnë më së voni pesë ditë para ditës së mbajtjes së zgjedhjeve.

Afati: 27.02.2023 deri në orën 24.

V. PUBLIKIMI I KALENDARIT

Ky kalendar do të publikohet në ueb faqen e Komisionit komunal zgjedhor të Tuzit.

Numër: 17/22
Tuz, 31.12.2022

KRYETARI,
Edmond Ujkaj d.v.

